



Primitur / Dohet Primito / Preclato Received / Dobuty	31.03	2022	2	viti god year
Organ dhjetra Organ Jednitca Org Unit	In Prot In Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKYMSHICK	1774/2022		115	



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.135/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari, anëtarë me Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, ka shqyrtuar ankesën e datës 15.02.2022 me numër A.nr.840/2021 të parashtruar nga ankuesi përmes postës së Kosovës me numër R1940584 të datës 11.02.2022, kundër Vendimi KA.nr.62/2021 me numër protokollit 01/3016 të datës 31.12.2021 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 31.03.2022, mori këtë:

### V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.135/2022 e datës 15.02.2022 e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vendimi KA.nr.62/2021 i datës 31.12.2021 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

### A r s y e t i m

Ankuesi me datë 15.02.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 786/2022 të regjistruar me numër A.nr.135/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimi KA.nr.62/2021, me numër të protokollit 01/3016 të datës 31.12.2021 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, më datë 18.02.2022 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë te Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës.



Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, më datë 01.03.2022 ka përcjell dokumentacionin e kërkuar me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova:* Ankesën me numër protokollit 786/2022 të regjistruar me numër A.nr.135/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesa e ankuesit e datës 06.12.2021 e parashtruar në Komisionin për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Vendimi KA.nr.62/2021 i datës 31.12.2021 i Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Pliko e datë 11.02.2022 përmes postës së Kosovës me numër R1940584; Përgjigje ne ankese e datës 01.03.2022 me shkresat e bashkangjitura; Njoftimi i datës 09.11.2021 nr. protokollit 03/1809; Propozimi për emërimin e kandidatëve të përzgjedhur; Raporti i datës 25.10.2021 i Komisionit Përzgjedhës; Deklaratë e datës 25.10.2021 prej 1/5 faqe; Raporti final i rekomandimit nga Komisioni Rekrutues i datës 09.11.2021; Renditja përfundimtare e kandidatëve; Përmbledhja e vlerësimeve individuale; Raporti i datës 25.10.2021 mbi përgatitjen e listën e ngushtë; Regjistri i aplikacioneve të pranuar i datës 03.06.2021; Përcaktimi i kritereve për testim me shkrim dhe me gojë për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja të gjuhës së huaj i datës 08.11.2021; Lista e kandidatëve që kanë kaluar nga testi me shkrim i datës 03.11.2021, dhe ata që nuk kanë kaluar testin me shkrim; Konkursi i jashtëm Nr.03/2021 i datës 20.05.2021 me nr. protokollit 03/970; Formulari i vlerësimit individual i datës 01.11.2021 në testim me shkrim dhe me gojë të datës 05.11.2021; Testi me shkrimi i datës 01.11.2021 F.T; Aplikacioni i ankuesit i datës 31.05.2021; Testimi me shkrimi datës 01.11.2021 F. Sh; Aplikacioni i ankuesit i datës 01.06.2021;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit *është e pa bazuar, sepse:*

Kolegji, bazuar në shkresat e lëndës ka konstatuar se Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me datë 20.05.2021 ka shpallur konkursin e jashtëm me numër Nr.03/2021 për dy (2) vende të lira të punës, për pozitën: *Referent i Lartë* në Gjykatën Themelore në Pejë/dega në Klinë, i cili konkurs ka qenë i hapur deri më datës 03.06.2021 dhe në të cilin ka aplikuar dhe ankuesi. Pas përfundimit të procedurës së rekrutimit Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me datë 09.11.2021 ka publikuar Njoftimin Nr.03/1809 të datës 09.11.2021 për kandidatët e përzgjedhur, duke udhëzuar palët për të drejtën e ankesë.

I pa kënaqur me njoftimin e datës 09.11.2021 me numër të protokollit 03/1809 për përzgjedhjen përfundimtare të kandidatëve, ankuesi me datë 06.12.2021 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, i cili me datë 31.12.2021 me numër të protokollit 01/3016 ka nxjerrë Vendimin KA.nr.62/2021 përmes të cilit ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e ankuesit dhe ka lënë në fuqi Njoftimi me numër 03/1809 të datës 09.11.2021 lidhur me përzgjedhjen përfundimtare.

Kundër Vendimi KA.nr.62/2021 me numër të protokollit 01/3016 të datës 31.12.2021, ankuesi me datë 15.02.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të



Kosovës, me pretendimin ankimor se procedura e rekrutimit nuk është zhvilluar në pajtim me Rregulloren Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, dhe propozon që të anulohet procedura përkatëse e rekrutimit dhe Vendimi KA.nr.62/2021 i datës 31.12.2021 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave shqyrtoj pretendimet ankimore të ankuesit dhe rrjedhimisht konstatoi se pretendimi ankimor si i tillë nuk është i qëndrueshëm sepse bazuar në shkresat e lëndës, gjegjësisht konkursin e jashtëm Nr.03/2021 të datës 20.05.2021 Kolegji ka gjetur se kriteret kualifikuese për vendin e punës *Referent i Lartë*, kanë qenë:

- *Diplomë universitare: Fakulteti Juridik;*
- *Dy vite përvojë pune.*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të dëshmive lidhur me përgatitjen profesionale dhe përvojën e punës të kandidatëve të përzgjedhur dhe ankuesit ka konstatuar se Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil pranë Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, poen-timin e kandidatëve për listë të ngushtë e ka bërë në bazë të nenit 28 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, ku përcaktohet se: *Anëtarët e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kriterëve në vijmë: 1.1 arsimimi dhe kualifikimi profesional; 1.2. përvoja e punës profesionale; 1.3. shkathtësitë dhe aftësitë; 1.4. elemente të tjera të meritës.*

Bazuar në shkresat e lëndës Kolegji ka gjetur se Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ka konstatuar se ankuesi dhe kandidatet e përzgjedhur i kanë plotësuar kushtet e konkursit dhe të njëjtit i ka përfshi në listë të ngushtë.

Sipas dosjes se lëndës do dorëzuar nga organi i punësimit është konstatuar se kandidatët e përzgjedhur për pozitën e punës *Referent i Lartë*, në Gjykatën Themelore në Pejë/dega në Klinë, janë si në vijim: e cila nga testimi me shkrim dhe me gojë ka arritur që t'i marr gjithsej 434 pikë dhe e njëjta është renditur e para në listën përfundimtare, ndërsa në testin me shkrim dhe me gojë ka arritur që t'i marr gjithsej 407.5 pikë dhe i njëjti është renditur i dyti në listën përfundimtare. Ndërsa ankuesi nga testimi me shkrim dhe me gojë ka arritur që t'i marr gjithsej 354 pikë të përgjithshme dhe është renditur i shtati në listën përfundimtare të kandidatëve dhe rrjedhimisht i njëjti nuk ka arritur pikët e mjaftueshme për tu përzgjedhur në pozitën përkatëse të punës.

Andaj duke marr parasysh se në shërbimin civil emërohen kandidatët që kanë numër më të madh të pikëve sipas nenit 40 paragrafit 1 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Kolegji konstaton se ankuesi nuk ka arritur pikët e mjaftueshme që të rekomandohet si kandidat i suksesshëm dhe rrjedhimisht të emërohet në pozitën e punës *Referent i Lartë* në Gjykatën Themelore në Pejë/dega në Klinë.

Kolegji ka konstatuar se kandidatja e përzgjedhur e renditur e para në listën përfundimtare, ka plotësuar kriterin kualifikues dhe atë të përvojës se punës sepse sipas shkresave të lëndës është konstatuar se e njëjta ka përfunduar studimet themelore me datë 15.06.2015 në Fakultetin Juridik të Universitetit "Haxhi Zeka" ndërsa sipas Kontratës të datës 01.04.2016 është konstatuar se e njëjta ka ushtruar pozitën e juristit nga 01.04.2016 deri me





01.04.2017 në Kosova Tours SH.P.K, ndërsa sipas Vetëtimti të datës 31.12.2019 është konstatuar se e njëjta ka kryer pune praktike në Agjencinë Kundër Korrupsionit, në kudër të projektit SAEK II/UNDP nga data 01.06.2018 deri me datë 31.12.2019. Po ashtu edhe kandidati i dytë i përzgjedhur ka plotësuar kriterin kualifikues dhe atë të përvojës së punës sepse sipas shkresave të lëndës është konstatuar se i njëjta ka përfunduar studimet themelore më datë 10.09.2014 në Fakultetin Juridik të Universitetit "Haxhi Zeka", në Pejë, si dhe në bazë të dëshmimeve në dosje e ka plotësuar edhe kriterin e përvojës së punës sepse sipas certifikatës së datës 06.01.2017 me numër I.A.GJ.nr.12/17 shihet se ka kryer praktikën gjyqësore në kohëzgjatje prej një (1) viti nga data 05.01.2016 gjerë më datën 04.01.2017 në Gjykatën Themelore në Pejë, ndërsa sipas kontratës së punës të datës 01.06.2019 dhe Vërtetimit të datës 01.06.2021 lëshuar nga zyra e Avokatit është konstatuar se i njëjti ka qenë në marrëdhënie të punës nga data 01.06.2019 gjerë më datën 01.06.2021.

Andaj, bazuar si me lartë Kolegji konstaton se Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës gjatë zhvillimit të procedurës së rekrutimit deri në përzgjedhjen përfundimtare, ka zbatuar drejtë ligjin material me rastin e përgatitjes së listës së ngushtë dhe vlerësimin e testit me shkrim dhe me gojë duke vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 37, 38 dhe 39 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, dhe rrjedhimisht rekomandimi për emërimi i kandidateve të suksesshëm është bërë në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, përkatësisht neni 11 paragrafit 1 ku përcaktohet se: *Pranimi në Shërbimin Civil të Kosovës bëhet në pajtim me parimet e meritës, aftësisë profesionale, paanshmërisë, mundësive të barabarta, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të barabartë, në bazë të konkursit publik dhe pas verifikimit të zotësisë së veprimit të kandidateve, dhe nenin 18 paragrafin 1 ku përcaktohet se: Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitave të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësinë e komisionit testues, mos diskriminimin e kandidateve dhe të drejtën për t'u ankuar në fund të procedurës.*

Pas përfundimit të procedurës së rekrutimit, institucioni përkatës, me datë 09.11.2021 ka publikuar njoftimin lidhur me përzgjedhjen përfundimtar në pajtim nenin 41 paragrafin 2 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, kështu që pretendimet ankimore të ankuesit janë të pa bazuar.

Kolegji, konstaton se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit KA.nr.62/2021 të datës 01.09.2021, për refuzimin e ankesës si të pa bazuar ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike, duke vepruar kështu në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave.

Andaj, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.



Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda me numër A.nr.135/2022**

Zyle Millaku GOJNOVCI

Procesmbajtëse

*Vendimi i dërgohet*

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Udhëheqëses së Personelit në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

